

Vendim nr. 246 datë 24.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese
Sandër Beci, Anëtar
Irir Toska, Anëtar

në datën 24.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **FIQIRIE MUÇA**, përfaqësuar nga avokat Roland Islami me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-15, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimi i procedurave të shqyrtimit të çështjes me përparësi.

Konstatimi i cenimit të së drejtës së aksesit dhe parimit të sigurisë juridike në një gjykatë të caktuar me ligj.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen me përparësi.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasja Fiqirete Muça (*kërkuesja*) ka pasur në posedim një sipërfaqe toke bujqësore prej 5900 m² të ndodhur në fshatin Maqellarë, Dibër, e cila ishte e ndarë në tre parcela, për të cilat kërkuesja ishte pajisur me Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (*AMTP*). Në vitin 2018 kërkuesja i është drejtuar me kërkesë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Dibër për regjistrimin e *AMTP*-ve të mësipërme. Në bazë të përgjigjes së *ZVRPP*-së, Dibër kjo pasuri rezultonte e regjistruar në emër të shtetasit B.M.Gj., ndaj kërkuesja është orientuar për ta zgjidhur çështjen e saj në rrugë administrative ose gjyqësore.

2. Në këto rrethana kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër Bashkisë Dibër, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të *AMTP*-së nr. 4716, datë 14.09.2000 (*AMTP-ja nr. 4716/2000*) dhe *AMTP*-së dublikatë nr. 4716, datë 02.06.2016 (*AMTP-ja duplikatë nr. 4716/2016*), të dhëna në emër të të paditurit B.Gj.; urdhërimin e *ZVRPP*-së, Dibër të bëjë fshirjen e regjistrimit të *AMTP*-së nr. 4716/2000 dhe të *AMTP*-së dublikatë nr. 4716/2016 në emër të të paditurit B.Gj.; sigurimin e padisë dhe marrjen e masave të përshtatshme për vendosjen e sekuestros për pasurinë me numër 591/3 deri në përfundimin e gjykimit.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2483, datë 10.07.2019, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë së kërkueses dhe konstatimin pjesërisht si absolutisht të pavlefshme të *AMTP*-së nr. 4716/2000 të lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Maqellarë, në emër të familjes bujqësore B. M. Gj. për sipërfaqen 850 m², ngastra nr. 170, me emërtimin “Gërmadë”, me sipërfaqe 1.500 m² dhe të *AMTP*-së duplikatë nr. 4716/2016 të miratuar nga Bashkia Dibër, në emër të familjes bujqësore B. M. Gj., për sipërfaqen 850 m², ngastra nr. 591/3, me emërtimin “Gërmadë”, me sipërfaqe 1.040 m² dhe zgjidhjen e pasojave sipas urdhërimeve vijuese të gjykatës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të pretendimeve të kërkueses. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur.

4. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.10.2019 me nr. 31157-03570-86-2019 akti. Në datën 06.11.2023 kërkuësja ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e procedurave gjyqësore për gjykimin e saj, duke caktuar një afat kohor sa më të përshtatshëm. Në këtë kërkesë ajo ka parashtruar tejkalimin e afatit 1-vjeçar të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), prej momentit të regjistrimit të saj në atë gjykatë; tejzgjatjen në mënyrë të paarsyeshme dhe pa shkak të ligjshëm, duke cenuar procesin e rregullt ligjor që sjell pasojat të rënda për të dhe për dhënien e drejtësisë.

5. Gjykata e Lartë, bazuar në nenin 399/4, pika 1, të KPC-së, ka kërkuar informacion nga gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit, në lidhje me fazën dhe procedurat e gjykimit të kësaj çështjeje. Me shkresën nr. 12038/1, datë 03.11.2023, gjyqtari relator ka parashtruar se për shkak të rishortimit të çështjes, kjo e fundit i ka kaluar në ngarkim përmes shortit të datës 14.09.2023. Për shkak të volumit të madh të çështjeve të regjistruara, referuar kalendarit të tyre, në atë gjykatë po shqyrtohen çështjet e vitit 2017, ndaj çështja e kërkuëses, nisur nga koha e ardhjes së dosjes dhe radhës së shqyrtimit, nuk është planifikuar ende për gjykim.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-15, datë 11.01.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuëses për shkelje të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes administrative prej Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se nuk konstatohet zvarritje e qëllimshme e saj nga gjyqtari relator.

7. Në datën 27.05.2024 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 26.06.2024. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 24.09.2024, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim, me qëllim parashtrimin e argumenteve nga ana e kërkuëses që provojnë rëndësinë e asaj çfarë rrezikon ajo për shkak të vonësës së gjykatës së apelit në shqyrtimin e çështjes së saj.

8. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuases

9. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të së drejtës së gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi:

9.1. Çështja objekt gjykimi është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.10.2019 dhe ndonëse kanë kaluar 4 vjet e 5 muaj, ende nuk ka një vendimmarrje për të. Thelbi i mosmarrëveshjes në gjykim në gjykatën e apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës dhe gjykimi i saj ka tejkaluar çdo limit të arsyeshëm, në kundërshtim me nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së. Vonesa në shqyrtimin e saj ka shkaktuar cenimin e së drejtës së pronës. Po kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim flagrant me nenin 6, pika 1, të KEDNJ-së dhe me Kushtetutën, ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe për përshpejtimin e çështjes, pasi ka vlerësuar se gjykata e apelit është në pamundësi objektive të përshpejtojë gjykimin.

(i) *Sjellja e kërkuases*. Sipas kërkuases, sjellja e saj nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjyqimit të çështjes në gjykatën e apelit. Në kushtet kur ajo gjykatë nuk kishte planifikuar një datë për shqyrtimin e çështjes së saj, kërkuësja ka vepruar në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së, duke paraqitur kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e çështjes. Edhe Gjykata e Lartë ka pranuar se në rastin konkret sjellja e kërkuases nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjyqimit të çështjes.

(ii) *Kompleksiteti i çështjes*. Çështja në gjykim nuk paraqitet komplekse që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej 5 vjetësh e 5 muajsh, fakt që është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë.

(iii) *Sjellja e autoriteteve*. Sipas kërkuases, shkak për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm është bërë sjellja e autoriteteve. Mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët. Ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vonesat për shkak të reformës janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që krijon procesi i saj.

(iv) *Çfarë përbën rrezik për kërkuesen*. Sipas saj, thelbi i mosmarrëveshjes që po gjykohet në gjykatën e apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës dhe vonesa

në shqyrtimin e çështjes gjyqësore ndikon negativisht në këtë të drejtë. Ndërkohë që Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkueses nuk i vjen ndonjë rrezik i veçantë nga mosgjykimi në afat i çështjes.

9.2. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë jurisprudencën kushtetuese dhe evropiane, sipas të cilave vetingu në drejtësi dhe mungesa e gjyqtarëve nuk mund të justifikojnë mosshqyrtimin në kohë të çështjes.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, për të cilin ka ngritur pretendime.

12. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm tashmë parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e neneve 399/2 e vijues të KPC-së, dhe

vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 06.11.2023 për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshem dhe përshpejtimin e gjykimit të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Kolegji Administrativ ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj, ndaj i vetmi mjet në dispozicion të kërkuarit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshem për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 11.01.2024, është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 02.02.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.05.2024. Si rrjedhim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuar është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se thelbi i pretendimeve të kërkuarës ka të bëjë me tejzgjatjen e procedurave gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së saj në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila *prima facie* përfshihet në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshem

17. Kërkesja ka pretenduar se çështja objekt gjykimi është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.10.2019 dhe ndonëse kanë kaluar 4 vjet e 5 muaj, ende nuk

ka një vendimmarrje për të. Thelbi i mosmarrëveshjes në gjykim në gjykatën e apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës dhe gjykimi i saj ka tejkaluar çdo limit të arsyeshëm, në kundërshtim me nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së. Vonesa në shqyrtimin e saj ka shkaktuar cenimin e së drejtës së pronës. Po kështu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim flagrant me nenin 6, pika 1, të KEDNJ-së dhe me Kushtetutën, ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e çështjes, pasi ka vlerësuar se gjykata e apelit është në pamundësi objektive të përshpejtojë gjykimin. Sipas kërkueses, sjellja e saj nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit. Në kushtet kur ajo gjykatë nuk kishte planifikuar një datë për shqyrtimin e çështjes së saj, ajo ka vepruar në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së, duke paraqitur kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e çështjes. Çështja në gjykim nuk paraqitet komplekse që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej 5 vjetësh e 5 muajsh, fakt që është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë, si dhe shkak për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm është bërë sjellja e autoriteteve. Mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët. Po sipas kërkueses, thelbi i mosmarrëveshjes që po gjykohet në gjykatën e apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës dhe vonesa në shqyrtimin e çështjes gjyqësore ndikon negativisht në këtë të drejtë.

18. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 37, datë 07.05.2024; nr. 21, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuësja në datën 20.03.2019 ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP-së nr. 4716/2000 dhe AMTP-së dublikatë nr. 4716/2016, të dhëna në emër të të paditurit B.Gj.; urdhërimin e ZVRPP-së, Dibër të bëjë fshirjen e regjistrimit të AMTP-ve të mësipërme; sigurimin e padisë, marrjen e masave të përshtatshme për vendosjen e sekuestros për pasurinë me numër 591/3 deri në përfundimin e gjykimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Pala e paditur e ka

ankimuar vendimin e mësipërm dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.10.2019. Si rezultat nga i fillimi i procesit kanë kaluar pothuajse 6 vjet, ndërsa nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit deri në shqyrtimin e saj në Gjykatë kanë kaluar pothuajse 5 vjet dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

20. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjes administrative, KPC-ja, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

21. Në vështrim të standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me *sjelljen e kërkueses*, Kolegji vëren se kërkuesja, pasi ka konstatuar se nuk ishte planifikuar shqyrtimi i ankimit të tij në gjykatën e apelit, në përputhje me parashikimet e KPC-së, në datën 06.11.2023 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj. Në këto kushte, Kolegji konstaton se, sikurse ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në ato momente nuk është kryer ndonjë veprim procedural (*shih paragrafin 16 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, Kolegji çmon se nuk rezulton që palët në proces të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

23. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, Kolegji vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012 datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Si palë në gjykimin në shkallë të parë krahas kërkueses kanë qenë Bashkia Dibër, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Dibër, Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit Dibër dhe shtetasi B. Gj. Në objektin e padisë së kërkueses kërkohet konstatimi i

pavlefshmërisë absolute të AMTP-së nr. 4716/2000 dhe AMTP-së dublikatë nr. 4716/2016, të dhëna në emër të të paditurit B.Gj.; urdhërimi i ZVRPP-së, Dibër të bëjë fshirjen e regjistrimit të AMTP-ve të mësipërme; sigurimi i padisë, marrja e masave të përshtatshme për vendosjen e sekuestros për pasurinë me numër 591/3 deri në përfundimin e gjyqimit. Në këtë çështje gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Ndërkohë, pala e paditur nëpërmjet ankimit ka vënë në lëvizje gjykatën e apelit. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se ashtu si edhe vetë Gjykata e Lartë ka çmuar (*shih paragrafin 16 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*), çështja paraqitet me kompleksitet mesatar nga natyra e saj.

24. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, Kolegji vëren se çështja e kërkueses është në pritje për shqyrtim në gjykatën e apelit tashmë prej pothuajse 5 vjetësh. Bazuar në informacionin e gjyqtares relatores në gjykatën e apelit drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja e kërkueses i është nënshtruar disa herë procedurës së rishortimit dhe në datën 14.09.2023 i ka kaluar për gjykim gjyqtares A.N. Ndërkohë që për shkak të ngarkesës dhe volumit të madh të çështjeve në këtë gjykatë, ajo nuk është planifikuar ende për gjykim, pasi aktualisht janë në radhë për gjykim çështjet e regjistruara në vitin 2017. Bazuar në treguesit e mësipërm, Kolegji vlerëson se kohëzgjatja e gjyqimit të çështjes së kërkueses lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

25. Në këtë drejtim, Kolegji vë në dukje se Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuessa*, Gjykata ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshejtim të posaçëm të gjyqimit, nisur nga interesi veçanërisht i lartë i kërkuessit. Disa çështje që lidhen me interesa

“vetjakë e jetësorë” nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi. Të tilla janë çështjet që kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe kriteri i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024, nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se në thelb të objektit të çështjes së kërkueses është cenimi i së drejtës së pronës private për një sipërfaqe toke bujqësore të ndodhur në fshatin Maqellarë, Dibër, e cila përmes AMTP-së nr. 4716/2000 dhe asaj dublikatë i është dhënë të paditurit B.Gj. Në argumentet shtesë të paraqitura nga ana e saj, kërkuesja pretendon se i është mohuar e drejta për të disponuar lirisht sendin në pronësi të saj, fakt që e kushtëzon atë për të ushtruar të drejtën e dhënies me qira apo shitjen e tij tek të tretë.

28. Bazuar në argumentet e paraqitura në kërkesë dhe në informacionin plotësues të saj, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës në kuptim të mosushtrimit prej saj të së drejtës për dhënien me qira apo shitjen e saj tek të tretë është paraqitur në mënyrë të përgjithshme, prandaj nuk përbën shkak të mjaftueshëm për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesat “vetjakë e jetësorë” të kërkueses të rrezikohen në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në gjykatën e apelit. Në këto kushte, në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja për shkak të vonesës së gjykatës së apelit në shqyrtimin e çështjes së saj, Kolegji çmon se në kontekst të rrethanave të rastit, kërkuesja nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e saj, natyra dhe rëndësia e të cilëve justifikojnë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së saj.

29. Si rrjedhim, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilës prej kriterëve të mësipërme që janë përcaktuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, në kuptim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja, Kolegji vlerëson se çështja e saj nuk përbën shkak të arsyeshëm në aspektin kushtetues për t’u shqyrtuar me prioritet, prandaj pretendimi i saj për cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.